

V E N D I M
Nr.331, datë 26.6.1995

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.111, DATË 3.3.1993

Me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Në kapitullin II/a, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

--Në të gjitha rastet kur në juridiksionon e bashkisë ka edhe fshatra, atëhere ngrihet dhe funksionon komisioni i tokave të bashkisë, i cili kryesohet nga kryetari i bashkisë, dhe ka të gjitha detyrat dhe atributet që prashikohem për komisionin e tokave në komunë.

Edhe në këtë rast këshilli i rrethit siguron mjetet financiare për ndarjen e tokës, si dhe administron e kontrollon këto fonde.

2.Pas paragrafit të parë të pikës 3 të vendimit të mësipër shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

-Komisioni i tokës në fshat është unikal dhe ekzekuton ndarjen e tokës, pavarësisht nga subjekti që i përkiste më parë.

3.Pika 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.452, datë 17.10.1992, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi